

1. PAMJE E PËRGJITHSHME

Tremujori i tretë i vitit 2001 karakterizohet nga një rritje e konsiderueshme e transaksioneve korente, e cila është shkaktuar kryesisht nga rritja e vlerës së transaksioneve të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve. Kështu, në fund të tremujorit këto transaksione regjistruan rreth 832 milionë dollarë dhe vlerësohen rreth 5 për qind më të larta se periudha paraardhëse. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve korente. Për rrjedhim, deficitit korent për tremujorin e dytë vlerësohet 84.2 milionë dollarë dhe është shkaktuar kryesisht nga rritja e deficitit tregtar të mallrave. Importet e kapitaleve prej 67 milionë dollarësh kanë mbuluar rreth 79.6 për qind të deficitit korent dhe kanë çuar në rritjen e rezervave valutore me 29 milionë dollarë.

TABELA 1. BILANCI I PAGESAVE GJATË VITEVE (në mln usd)

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	3M-III '00	3M-III '01
LLogaria Korrente	18.8	31.4	36.6	-62.3	-253.7	-65.0	-132.9	-163.1	29.3	-84.2
Eksporti i mallrave fob	111.6	141.4	204.8	243.7	158.6	208.0	275.1	255.4	63.5	58.5
Importi i mallrave fob	-620.5	-601.0	-679.8	-922.0	-693.5	-811.7	-937.9	-1,076.4	-261.1	-312.5
Bilanci tregtar	-508.9	-459.6	-475.0	-678.3	-534.9	-603.6	-662.8	-821.0	-197.6	-254.1
Shërbimet: Kredi	76.3	83.1	98.2	127.3	67.9	86.6	266.7	448.1	117.4	132.8
Shërbimet: Debi	-165.3	-97.5	-106.3	-142.3	-101.1	-129.3	-165.4	-430.0	-115.9	-121.3
Të ardhurat: Kredi	19.8	55.6	70.8	83.5	61.6	86.1	85.6	115.9	30.2	43.5
Të ardhurat: Debi	-31.0	-41.4	-28.5	-12.0	-11.9	-8.7	-10.3	-9.1	-2.5	-4.0
Transferrat private	324.1	374.1	348.9	476.0	235.7	421.3	188.4	438.6	143.2	109.9
Transferrat shtetërore	303.9	117.1	128.5	83.4	29.0	82.6	165.0	94.4	54.5	8.8
Llogaria kapitale	0.0	21.6	389.5	4.9	2.1	31.1	67.5	78.2	19.5	61.2
Llogaria financiare	104.2	24.2	-414.5	49.6	140.7	16.0	36.8	182.5	27.3	0.0
Investime direkte	68.0	53.0	70.0	90.1	47.5	45.0	41.2	143.0	63.0	33.9
Investime portofoli	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-25.0	0.0	-13.0
Kapitale të tjera	36.2	-28.7	-484.5	-40.5	93.2	-29.0	-4.4	64.5	-35.7	-22.8
Gabime dhe harrresa	-24.7	-44.5	7.9	54.8	142.5	69.4	131.3	15.0	-4.2	46.3
Bilanci i përgjithshëm	114.9	54.9	30.6	47.0	43.8	59.4	123.5	131.9	75.1	29.2
Rezerva & zëra të lidhur me të										
Mjetet e rezervës	-114.9	-54.9	-30.6	-47.0	-43.8	-59.9	-123.6	-131.9	-75.1	-29.2
Përdor. kred. & huash nga fondi	16.6	22.2	11.1	0.0	12.2	7.9	20.9	19.3	3.1	5.9
Det. ndaj Auto. Monet. të Huaja
Financime të jashtëzakonshme
Për t'u përmendur										
Ndryshim i Rezervave	118.7	-54.8	-30.6	-39.5	-28.3	-75.9	-97.4	-130.5	-55.9	-46.1
Efektet nga Kursi i Këmbimit	-3.8	7.3	5.1	-7.3	-15.5	12.6	-26.2	-3.5	-19.2	21.0

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në *tregtinë e jashtme* në mallra, për tremujorin e tretë nuk mund të konsiderohen të favorshme. Vihet re një rënie e madhe e eksporteve kryesisht në muajt korrik, gusht. Totali i transaksioneve tregtare, megjithëse është rritur rreth 14.3 për qind kundrejt tremujorit respektiv një vit më parë, krahasuar me tremujorin paraardhës ka rënë me 9.2 për qind.

Importi i mallrave vlerësohet 312 milionë dollarë amerikanë ose rreth 19.7 për qind më i lartë kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e importeve të larta në grupmallrat “makineri e pajisje” me rreth 1.8 herë, “ushqime, pije e duhan” dhe ato “tekstile dhe artikuj të tyre“. Gjithashtu, tremujori i tretë si vazhdimësi e gjashtëmujorit të parë të vitit, pati rritje të larta të importit edhe nën ndikimin e krizës energjitike, e cila përfshiu vendin. Kjo krizë u reflektua në importe të larta në grupin “produkte minerale” ku përfshihen edhe importet e energjisë elektrike e ato të lëndëve djegëse.

Eksporti i mallrave ka rënë afërsisht 8 për qind kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë dhe rreth 33 për qind kundrejt tremujorit paraardhës. Kjo rënie është shkaktuar tërësisht prej rënies së rieksperteve nga përpunimi aktiv, të cilat përfaqësohen kryesisht nga grupmallrat e tekstileve dhe këpucëve. Kështu grupi “veshje këmbë, koke dhe çadra etj.“, që përbën edhe grupin kryesor të përpunimit aktiv, ka rënë me rreth 45 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Po kështu, kundrejt të njëjtës periudhë, grupet “metale bazë” dhe “ushqime, pije e duhan” kanë rënë respektivisht me rreth 36 për qind dhe 20 për qind.


Deficiti tregtar arriti në 254.1 milionë dollarë amerikanë ose 28.6 për qind më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Edhe këtë tremujor tregtia është e orientuar drejt vendeve të Bashkimit Europian me rreth 86 për qind të volumit të transaksioneve tregtare.

Zhvillimet në *tregtinë e shërbimeve*, për këtë tremujor, evidentojnë rritje si të shpenzimeve ashtu edhe të të ardhurave. Suficiti i tregtisë së shërbimeve arriti në 11.5 milionë dollarë. Shërbimet e turizmit luajnë rolin kryesor në bilancin e shërbimeve edhe për këtë tremujor.

Bilanci pozitiv i të ardhurave vlerësohet 39.5 milionë dollarë amerikanë ose rreth 42.6 për qind më i lartë se e njëjta periudhë një vit më parë. Kjo rritje është mundësuar kryesisht prej të ardhurave më të larta nga investimet e mjeteve valutore të sistemit bankar me rreth 27.8 për qind dhe të ardhurave nga puna me rreth 1.7 herë.

Transfertat korente vlerësohen me një bilanc pozitiv prej 119 milionë dollarësh. Rolin kryesor në transfertat korente e luajnë dërgesat nga emigrantët, që për këtë tremujor, vlerësohen rreth 130.4 milionë dollarë amerikanë. Vihet re një rënie e këtyre transfertave kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë prej 24 për qind. Rënie kanë pësuar edhe transfertat shtetërore prej rreth 6 herë.



Grafik 1. LLOGARITË E BILANCIT TË PAGESAVE.


Deficiti, relativisht i lartë, i transaksioneve korente është financuar prej *flukseve hyrëse të kapitaleve*, bilanci pozitiv i të cilave, në fund të periudhës, vlerësohet me rreth 67.1 milionë dollarë. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale prej rreth 61.2 milionë dollarësh dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 5.9 milionë dollarësh.

2. LLOGARIA KORENTE

Tremujori i dytë pasqyron një rritje të volumit transaksioneve korente kundrejt tremujorit paraardhës edhe atij korrespondues një vit më parë, me rreth 5 dhe 1 për qind, duke regjistruar shifrën 832 milionë dollarë. Kjo rritje vjen kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve korente, të cilat në fund të tremujorit vlerësohen rreth 458.3 milionë dollarë, shifër kjo rreth 3 për qind më e lartë se tremujori paraardhës. Krahasuar me tremujorin e dytë të këto shpenzime janë rritur rreth 14.8 për qind.

Të ardhurat korente vlerësohen 374 milionë dollarë ose rreth 12.3 më të ulëta se tremujori i tretë i vitit 2000. Në këtë rënie kanë ndikuar eksportet e ulta tregtare si dhe transfertat e njëanshme (krahasuar me tremujorin e tretë një vit më parë këto vlerësohen rreth 35.8 për qind më të ulëta).

Kështu, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2001 deficitit i llogarisë korente vlerësohet rreth 84 milionë dollarë. Ky deficit është rrjedhojë kryesisht e deficitit tregtar të mallrave.



Grafik 2. LLOGARIA KORENTE DHE BILANCI FISKAL

Deficiti i llogarisë korente, përjashtuar transfertat shtetërore, këtë tremujor vlerësohet 3.5 herë më i lartë se e njëjta periudhë një vit më parë duke regjistruar shifrën 93.1 milionë dollarë.

2.1 TREGTIA E JASHTME


Volumi i përgjithshëm i tregtisë së jashtme, i cili këtë tremujor ka ardhur në rënie kundrejt tremujorit paraardhës me rreth 9 për qind, u vlerësua rreth 371 milionë dollarë. Kjo rënie i dedikohet kryesisht eksporteve, të cilat brenda këtij tremujori patën një rënie të ndjeshme, kryesisht në muajt korrik dhe gusht. Megjithatë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2000 ky volum është rritur me rreth 14 për qind.

Kështu importi tregtar regjistroi rreth 312.5 milionë dollarë dhe përfaqëson 84 për qind të volumit tregtar ose 4 pikë përqindje më shumë se ajo e tremujorit të kaluar dhe atij korrespondues një vit më parë. Megjithatë, importi paraqitet në rënie prej rreth 3 për qind kundrejt tremujorit të dytë të vitit. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit të kaluar, importi u vlerësua me një rritje prej 19.6 për qind. Kanë ndikuar në këtë rritje, ndryshe nga viti i kaluar, zhvillimet pozitive në fushën e investimeve të brendshme dhe të huaja, të cilat kanë rritur importin e makinerive dhe të pajisjeve.

Muaji shtator përfaqëson periudhën me volumin më të lartë të importit brenda tremujorit.

Eksporti i mallrave, i vlerësuar në rreth 58 milionë dollarë, regjistroi një rënie të madhe si kundrejt periudhës paraardhëse me rreth 33.2 për qind, ashtu edhe rreth 8 për qind, kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë. Rënia e ndjeshme e eksporteve nga prodhimi i brendshëm si dhe rieksperti për përpunim aktiv, kryesisht në grupmallrat tekstile dhe artikujt e tyre dhe produktet minerale, që janë grupmallrat mbizotërues në këto lloj eksportesh, kanë qenë faktori kryesor në këtë rënie.

Edhe në eksport muaji shtator ka kapur shifrën më të lartë në këtë tremujor.



Grafik 3. TENDENCA NË ECURINË E EKSPORTIT DHE TË IMPORTIT.

Importet ndihma vlerësohen rreth 2 milionë dollarë. Ndihmat ishin kryesisht në produkte të industrisë tekstile dhe në makineri e pajisje.

Rënia e ndjeshme e eksporteve këtë tremujor u shoqërua me thellimin e deficitit tregtar. Kështu, në fund të këtij tremujori ai regjistroi rreth 254 milionë dollarë. Ky deficit vlerësohet rreth 28.6 për qind më i lartë se periudha korresponduese një vit më parë dhe rreth 9 për qind më i lartë se tremujori paraardhës.

Rezerva valutore bruto, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2001, vlerësohet e mjaftueshme për të përballuar 6.2 muaj importe (importe mallrash).


Tabela 2. TREGTIA E JASHTME SIPAS TREMUJORËVE PËR PERIUDHËN '94-'01
(në mln usd)

Periudha	Eksport	ndryshimi në % ndaj periudhës paraardhëse	Import	ndryshimi në % ndaj periudhës paraardhëse
T1 1994	27.9	-19.7	-122.1	-29.7
T2 1994	30.7	10.0	-149.0	22.1
T3 1994	30.9	0.6	-155.0	4.0
T4 1994	51.8	67.5	-174.9	12.8
T1 1995	42.0	-19.0	-163.5	-6.5
T2 1995	51.1	21.8	-177.0	8.2
T3 1995	57.3	12.0	-150.4	-15.0
T4 1995	54.5	-4.8	-188.8	25.5
T1 1996	68.0	24.8	-208.4	10.3
T2 1996	57.1	-16.0	-209.6	0.6
T3 1996	56.5	-1.1	-225.2	7.4
T4 1996	62.1	9.9	-278.8	23.8
T1 1997	34.2	-44.8	-143.9	-48.4
T2 1997	42.2	23.2	-114.5	-20.4
T3 1997	41.3	-2.1	-171.1	49.3
T4 1997	40.9	-0.9	-264.0	54.3
T1 1998	42.2	3.2	-176.8	-33.0
T2 1998	49.3	16.8	-198.1	12.1
T3 1998	53.0	7.5	-196.1	-1.0
T4 1998	63.4	19.6	-240.6	22.7
T1 1999	72.9	15.0	-185.6	-22.9
T2 1999	78.4	7.5	-250.1	34.8
T3 1999	58.6	-25.2	-252.1	0.8
T4 1999	65.1	11.1	-250.1	-0.8
T1 2000	61.6	-5.4	-227.3	-9.1
T2 2000	68.5	11.2	-257.3	13.2
T3 2000	63.5	-7.3	-261.1	1.5
T4 2000	62.2	-2.1	-324.3	24.2
T1 2000	78.5	26.2	-288.5	-11.0
T2 2000	87.6	11.6	-318.3	12.3
T3 2001	58.5	-33.2	-312.5	-1.8

Struktura në eksporte dhe importe sipas përpunimit aktiv

Aktiviteti tregtar në fushën e përpunimit aktiv këtë tremujor zuri rreth 44 për qind të transaksioneve tregtare. Krahasuar me tremujorin paraardhës ky volum ka rënë me rreth 23 për qind, ndërkohë që kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë vihet re një rritje prej 9 për qind.

Eksporti për përpunim aktiv këtë tremujor identifikohet në rënie kundrejt tremujorit të dytë të vitit në vazhdim me rreth 28 për qind dhe në rritje me rreth 5 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Këto eksporte përfaqësojnë përgjithësisht aktivitetin e subjekteve me kapital të huaj, kryesisht në industrinë e veshjeve tekstile, mjete transporti dhe përpunimin e lëkurëve, të cilat zënë përkatësisht 38, 30 dhe 24 për qind të totalit dhe vazhdojnë të mbeten



grupmallrat kryesorë përpunues në vend.

Grafik 4. BILANCI TREGTAR (në mln usd).

Importi për përpunim aktiv zuri këtë tremujor rreth 13 për qind të totalit të importeve. Realizimi i importeve të kësaj kategorie vlerësohet me rritje rreth 15 për qind kundrejt tremujorit të tretë të vitit të kaluar, ndërkohë që ka pësuar rënie prej rreth 18 për qind ndaj tremujorit paraardhës. Importi për përpunim aktiv hyn kryesisht si importe në tekstile dhe artikuj tekstil, produkte të industrisë kimike dhe metale bazë, përkatësisht në masat 59, 16 dhe 8 për qind. Importet e kësaj kategorie regjistruan rënie prej 18 për qind kundrejt tremujorit korrespondues të

vitet 2000.

Importi dhe eksporti sipas grupmallrave

Grupmallrat kryesorë që zënë pjesën më të madhe të importit dhe që kanë ndikuar në tendencat e tij këtë tremujor janë makineri e pajisje mekanike dhe elektrike, produkte minerale, tekstile dhe artikuj, ushqime, pije e duhan dhe metale bazë, të cilat zënë rreth 60.4 për qind të totalit të importeve .

Kështu, volumi i importeve në **makineri e pajisje mekanike, elektrike etj.** zë rreth 19 për qind të importeve. Rritja e investimeve në vend këtë vit ka bërë që këto importe të rriten rreth 1.8 herë kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, ndërkohë që këto kanë rënë rreth 2.4 për qind kundrejt tremujori të dytë të vitit në vazhdim. Italia Greqia dhe Gjermania mbeten tregjet kryesore në këto importe.

TABELA 3. IMPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE.

	1996	1997	1998	1999	2000	tetor	netor	dhjetor	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtat
Kafshët e gjalla; Produkte me origjinë kafshore	47.1	27.4	42.4	41.4	30.3	2.7	2.5	3.0	1.7	1.8	2.5	2.2	2.3	2.5	2.1	1.9	2.5
Produkte vegjetale	163.0	85.3	83.0	85.9	90.7	6.0	6.4	11.4	7.8	9.0	9.1	10.1	8.9	6.7	7.7	6.0	6.6
Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	26.7	20.7	27.1	18.0	21.3	1.8	1.3	2.2	1.0	1.8	1.1	1.7	1.6	1.5	1.6	0.9	1.2
Ushqime të përgatitura, pije, duhan	88.5	47.0	73.0	108.8	97.6	8.4	8.3	8.4	7.6	6.9	8.8	8.0	10.0	7.5	9.0	10.0	9.9
Produkte minerale	48.6	49.2	70.0	81.3	141.7	11.8	22.4	16.7	15.9	13.8	17.9	15.5	8.9	15.1	12.3	14.7	15.0
Produkte të industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	45.1	38.3	61.8	51.4	60.4	4.3	3.4	6.0	3.6	6.1	6.4	7.4	5.9	6.1	6.3	6.1	6.0
Plastika; goma dhe artikuj të tyre	21.5	19.9	25.0	26.6	31.9	2.9	2.8	2.7	2.4	2.3	3.3	2.6	3.3	3.0	3.8	3.2	3.0
Lëkura, artikuj të tyre	19.8	14.4	19.0	21.1	19.0	1.4	2.2	1.6	1.9	2.6	2.3	1.8	2.4	1.9	2.3	1.8	2.6
Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	7.4	7.6	10.2	16.2	10.4	1.0	0.8	1.1	0.8	0.9	0.7	0.8	1.4	1.0	1.1	0.8	1.2
Brumi i drurit, letra, kartoni art. të tyre	13.4	8.5	12.8	14.3	17.0	1.5	1.2	1.6	1.2	1.2	1.5	1.5	2.0	2.2	2.1	1.4	1.6
Tekstile dhe artikuj tekstile	84.3	66.8	106.2	118.1	128.5	10.8	11.8	11.2	10.1	9.9	10.7	10.4	12.1	12.7	11.7	7.5	10.9
Veshjet e këmbëve, të kokës, cadrat	58.6	36.9	40.4	34.8	27.7	3.5	3.4	3.4	3.3	3.8	4.4	4.3	3.9	4.0	3.4	2.0	3.9
Art. prej guri, allcie, cimentoje; qeramike; qelq	22.3	22.3	28.7	30.1	41.9	3.9	4.0	4.1	2.6	3.3	2.8	3.9	4.8	4.2	3.9	4.1	4.7
Perla; bizhuteri; monedha	1.3	0.2	0.4	0.9	2.7	0.0	0.0	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	44.8	42.8	54.8	75.8	83.8	11.5	7.9	9.1	6.1	7.5	7.8	8.8	8.4	8.7	8.8	7.0	13.8
Makineri e pajisje mekanike, elektrike	151.3	101.9	81.1	108.9	148.9	15.5	14.8	28.9	13.2	12.7	17.5	17.8	20.7	23.3	22.9	13.6	23.8
Mjete transporti	57.2	31.9	55.1	70.6	80.1	6.3	5.6	6.2	6.2	6.0	5.8	6.1	6.5	5.6	4.7	5.6	5.5
Instrumente e aparate optike; orë; instr. muzikore	12.4	8.1	8.7	13.1	18.6	1.7	0.6	4.1	2.1	0.7	2.1	0.8	1.1	1.7	1.0	1.4	4.0
Armë e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	0.7	0.5	0.7	2.0	0.4	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	19.1	14.6	21.4	23.6	26.0	2.5	2.6	2.5	1.5	1.9	2.0	2.0	2.5	3.9	2.7	2.1	2.0
Vepra arti, copa të mbledhura nga antikitet	0.1	0.0	1.7	0.0	0.3	0.0	0.1	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI	933.1	644.4	823.5	943.0	1079	97.6	101.9	124.8	89.3	92.5	106.7	105.6	106.9	111.5	107.5	90.2	118

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Statistikat e publikuara u përshtaten kornizave metodologjike të BOP.

Importi në **produktet minerale**, i cili këtë tremujor zë rreth 13 për qind të totalit të importeve, vlerësohet në rritje si kundrejt tremujorit paraardhës ashtu edhe ndaj atij korrespondues respektivisht me rreth 6 për qind dhe 13.7 për qind. Rritja e volumit të importuar në karburante përbën faktorin kryesor në importet në rritje të importit të produkteve minerale.

Grupmali **tekstile dhe artikuj të tyre** u vlerësua në rritje ndaj periudhës

korresponduese të vitit të kaluar, me rreth 6 për qind, ndërkohë paraqitet me rënie kundrejt tremujorit të dytë me rreth 14 për qind. Kjo rënie ka ardhur si rezultat i rënies së industrisë së përpunimit aktiv, e cila në vendin tonë mbetet e përqendruar në përpunimin e mallrave tekstil. Italia përfaqëson tregun kryesor në këto importe. Importi në grupmallin **ushqim, pije dhe duhan**, këtë tremujor, përfaqësoi 9 për qind të importeve dhe u karakterizua nga tendenca në rritje prej 13 për qind kundrejt tremujorit paraardhës, me rreth 9 për qind kundrejt periudhës korresponduese të një viti më parë.

Grupmalli **metalet bazë dhe artikujt prej tyre** regjistroi një shifër rreth 40 për qind më të lartë se periudha korresponduese një vit më parë dhe rreth 14.4 për qind më e lartë se tremujori paraardhës, duke zënë rreth 9 për qind të totalit të importeve. Ndër importet brenda këtij grupmalli përmendim importet e hekurit, të çelikut dhe artikujt prej gize, të cilat ndikojnë ndjeshëm në këtë rritje.

Eksporti tregtar paraqitet me rënie si kundrejt tremujorit paraardhës ashtu edhe ndaj periudhës korresponduese të vitit 2000. Rënia e eksporteve është rrjedhojë kryesisht e rënies në grupmallrat kryesorë tekstil, veshje të kokës, këmbëve dhe metale bazë, të cilat zënë rreth 73 për qind të totalit të eksporteve.

Tabela 4. EKSPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE.

	1996	1997	1998	1999	2000	tetor	ntor	dhjetor	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershc	korrik	gusht	shtator
Kafshët e gjalla; Produkte me origjinë kafshore	6.9	4.1	4.1	3.4	1.8	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.3	0.4	0.3	0.3	0.2
Produkte vegjetale	16.0	15.5	16.2	12.6	12.1	1.2	1.2	0.7	1.0	0.8	1.1	0.7	0.6	0.7	0.7	1.0	1.4
Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	4.8	0.0	0.5	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Ushqime të përgatitura, pije, duhan	9.2	9.0	12.6	12.7	13.7	2.1	0.9	0.5	0.7	0.8	1.0	0.5	1.0	1.3	1.0	1.1	1.4
Produkte minerale	23.1	8.4	23.7	17.5	7.4	0.2	0.1	0.2	0.1	2.3	0.5	1.3	0.1	0.1	0.1	0.2	0.3
Produkte të industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	2.6	1.2	0.7	0.7	1.4	0.1	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.5	0.1	0.2	0.2	0.1	0.3
Plastika; goma dhe artikuj të tyre	1.2	0.5	1.1	1.3	0.9	0.0	0.0	0.1	0.0	0.2	0.0	0.1	0.0	0.1	0.0	0.1	0.0
Lëkura, artikuj të tyre	10.2	8.2	6.6	7.0	8.3	0.7	0.8	1.0	1.1	0.9	1.2	1.2	1.0	0.7	0.3	1.1	1.1
Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	6.2	5.3	5.6	6.4	7.3	0.7	0.7	0.5	0.5	0.9	0.8	0.6	0.7	0.6	0.6	0.4	1.2
Brumi i drurit, letra, kartoni art. të tyre	3.1	3.7	2.9	4.6	2.6	0.2	0.2	0.3	0.2	0.1	0.1	0.2	0.1	0.2	0.1	0.1	0.1
Tekstile dhe artikuj tekstile	54.7	36.2	69.6	98.3	108.7	6.5	7.4	8.1	8.9	10.4	11.4	8.9	8.6	10.8	8.0	6.0	13.6
Veshjet e këmbëve, të kokës, cadrat	52.6	27.4	40.7	67.9	69.0	5.5	5.9	6.6	6.5	7.6	9.0	9.4	9.7	7.5	4.5	3.4	3.4
Art. prej guri, allcie, cimentoje, qeramike, qelq	0.4	0.4	1.7	0.6	0.7	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1
Perla; bizhuteri; monedha	0.1	0.1	0.2	0.8	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	4.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	25.4	14.3	9.4	14.6	21.5	2.2	1.7	1.4	2.4	2.3	2.3	2.4	2.9	2.9	0.8	1.2	1.5
Makineri e pajisje mekanike, elektrike	3.8	7.4	4.3	12.4	4.4	0.7	0.4	0.2	0.3	0.4	0.3	1.4	1.6	0.7	0.2	0.2	0.3
Mjete transporti	0.1	0.5	1.2	5.0	0.2	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0	0.6	0.0	0.0	0.0
Instrumente e aparate optike; orë; instr. muzikore	0.2	0.1	0.8	0.4	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Armë e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	0.7	0.0	0.0	0.0	1.7	0.5	0.5	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.4	0.0	0.0
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	3.2	3.4	6.1	7.9	7.1	0.0	0.7	0.0	0.4	0.5	0.4	0.4	0.6	0.6	0.4	0.2	0.3
Vepra arti, copa të mbledhura nga antikitet	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0
TOTALI	224.5	145.9	208.0	274.4	255.9	20.8	21.0	20.4	22.5	27.4	28.6	31.8	27.9	27.8	18.0	14.8	25.6

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Statistikat e publikuara u përshtaten kornizave metodologjike të BOP.

Eksporti në grupmallin **tekstile dhe artikujt të tyre**, i ardhur kryesisht nga industria e përpunimit në vend, kryeson eksportet tona në një total prej 42 për

qind të volumit. Këtë tremujor, eksportet e këtij grupmali paraqiten rreth 2.2 herë më të ulëta kundrejt periudhës paraardhëse dhe krahasuar me periudhën korresponduese të vitit të kaluar, këto kanë rënë me rreth 2 për qind. Kjo rënie vjen kryesisht si rrjedhojë e rënies së industrisë së përpunimit aktiv kryesisht në muajt korrik, gusht.

Eksporti në **grupmallin veshje koke, këmbë etj.** përfaqëson rreth 26 për qind të totalit të eksporteve dhe paraqitet me një rritje të vogël prej 5 për qind nga tremujori i tretë i vitit 2000, ndërkohë që krahasuar me tremujorin e dytë të vitit në vazhdim, këto eksporte kanë pësuar një rënie të ndjeshme prej rreth 43.5 për qind. Edhe kjo rënie vjen nga rënia e industrisë së përpunimit aktiv në vend.

Eksporti në **metale bazë dhe artikujt prej tyre** ka pësuar rënie të ndjeshme ndryshe nga tendencat pozitive të zhvillimit të gjashtëmujorit të parë të vitit. Kështu, këto eksporte vlerësohen rreth 36 për qind më të ulëta se tremujori i tretë i vitit të kaluar dhe rreth 2.4 herë më të ulëta se periudha paraardhëse. Metalet përfaqësojnë grupmallin kryesor në eksportin e brendshëm.

Partnerët tregtarë

Shqipëria zhvillon aktivitetin e saj tregtar me botën e orientuar kryesisht (me rreth 86 për qind të totalit) drejt vendeve të Bashkimit Europian. Tregtia me këto vende vlerësohet në rënie si kundrejt tremujorit korrespondues të një viti më parë (8 për qind) ashtu edhe kundrejt tremujorit paraardhës (27 për qind).

Importi me këto vende përfaqëson 79 për qind, ndërsa eksporti 94 për qind. Edhe këtë tremujor Italia rezulton partneri më i madh i Shqipërisë në tregti me 50 për qind të volumit tregtar, pasuar nga Greqia me 29 për qind.

Tregtia me vendet e Europës Lindore zë vetëm 6 për qind të aktivitetit tregtar. Aktiviteti tregtar me Bullgarinë, Slloveninë, Rumaninë dhe Rusinë përfaqëson tregtinë me vendet e Europës Lindore. Gjatë tremujorit të tretë tregtia me këto vende ka rënë rreth 7 për qind kundrejt tremujorit paraardhës.

Me pjesën tjetër të botës, tregtia e zhvilluar kryesisht me Turqinë, Maqedoninë, dhe Jugosllavinë zë rreth 6 për qind të tregtisë dhe vlerësohet 15 për qind më e

ulët se tremujori paraardhës.

Shkëmbimet tregtare me Italinë.

Italia mbetet kryesuese në aktivitetin tregtar të Shqipërisë me botën. Kundrejt tremujorit paraardhës të vitit në vazhdim, tregtia me Italinë, si volum, paraqiti një rënie prej 18.6 për qind duke regjistruar rënie si në importe me 8 për qind, ashtu edhe në eksporte me 37 për qind. Ndërkohë, krahasuar me tremujorin e parë, volumi i tregtisë me Italinë është rritur 4 për qind. Kjo rritje pasqyrohet në import me rreth 8 për qind, ndërkohë që eksporti më këtë vend ka rënë me rreth 5.5 për qind.

Eksporti me Italinë përfaqësohet kryesisht nga grupmallrat veshje këmbë, koke dhe tekstilet e artikuj tekstil, të cilët përfaqësojnë industrinë e përpunimit aktiv dhe zënë respektivisht 38 dhe 37 për qind të totalit. Këtë tremujor rënia e këtij lloj eksporti ka ndikuar në rënien në eksportet me Italinë dhe, në përgjithësi, në totalin e eksporteve.

Importi me Italinë përfaqësohet kryesisht nga grupmallrat makineri e pajisje mekanike dhe pajisje elektrike, artikuj tekstil dhe mjete transporti, të cilat zënë respektivisht 43 për qind të importeve me këtë shtet.

Shkëmbimet tregtare me Greqinë.

Aktiviteti tregtar me Greqinë, gjatë këtij tremujori, u vlerësua 19 për qind më i lartë, krahasuar me tremujorin paraardhës. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes si të importit me 6 për qind, ashtu edhe të eksportit me 31 për qind. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2001 tregtia me këtë shtet, gjatë këtij tremujori, ka shënuar ritme pozitive. Kështu, volumi tregtar është rritur rreth 26.8 për qind; me një rritje prej 31 për qind në importe, ndërkohë që eksportet kanë rënë me rreth 3 për qind. Grupmallrat kryesorë në importe janë produkte minerale, makineri e pajisje, të cilat zënë respektivisht 20, 10 për qind të importeve me këtë shtet.

Eksportet me Greqinë përfaqësohen nga grupmallrat “tekstile dhe artikuj tekstile” me 64 për qind, të pasuar nga eksportet në “ushqime, pije, duhan” me rreth 20 për qind të eksporteve me këtë vend partner.

Shkëmbimet tregtare me Gjermaninë

Aktiviteti tregtar me Gjermaninë vlerësohet në rënie si volum kundrejt tremujorit të dytë të vitit me rreth 19 për qind. Rënia e këtij volumi vjen si rezultat i rënies së importeve me 25 për qind, ndërkohë që eksportet janë rritur me 8 për qind. Krahasuar me tremujorin korrespondues një vit më parë, transaksionet tregtare janë rritur 2 për qind. Kështu, importet me Gjermaninë u rritën me rreth 10 për qind, rritje kjo që u shoqërua me rënie në eksporte me rreth 18 për qind.

Importet në mjete transporti, të cilat zënë rreth 43 për qind të importit me Gjermaninë, përbëjnë shkakun kryesor në rritjen e volumit të importit.

Eksportet përfaqësohen nga grupmallrat “tekstile e artikuj tekstil” dhe “produkte vegjetale”, të cilat zënë respektivisht 62 dhe 22 për qind të totalit të eksporteve me Gjermaninë.

2.2 SHËRBIMET


Transaksionet e shërbimeve këtë tremujor u mbyllën me një bilanc pozitiv prej 11.5 milionë, ndërkohë që tremujori paraardhës ashtu edhe ai korrespondues një vit më parë kanë regjistruar deficit.

Kështu, eksporti i shërbimeve (rreth 133 milionë dollarë) vlerësohet rreth 15 dhe 22.6 për qind më i lartë si kundrejt tremujorit të tretë të vitit 2000, ashtu edhe kundrejt tremujorit paraardhës.

Importi i shërbimeve, këtë tremujor, regjistron 121 milionë dollarë dhe vlerësohet i rritur me 11.2 për qind kundrejt tremujorit të dytë dhe me rreth 5 për qind kundrejt periudhës korresponduese një vit më parë.

Rolin kryesor në bilancin e shërbimeve e luajnë të ardhurat dhe shpenzimet e shërbimeve të turizmit, të cilat zënë respektivisht rreth 83 dhe 65 për qind të eksportit dhe importit të shërbimeve. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, bilanci i shërbimeve të turizmit, në fund të tremujorit të tretë të vitit, vlerësohet pozitiv, rreth 31.6 milionë dollarë amerikanë. Kjo metodikë, bazohet në rezultatet e dala nga një vrojtim statistikor i Bankës së Shqipërisë për të

ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti turistik. Vihet re një rritje e të ardhurave nga turizimi prej rreth 19.6 për qind kundrejt tremujorit paraardhës. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të turistëve që kanë vizituar Shqipërinë, kryesisht nga emigrantët që janë kthyer në shtëpitë e tyre për të kaluar pushimet e verës.



Grafik 5. BILANCI I SHËRBIMEVE.

2.3 TË ARDHURAT


Bilanci pozitiv i të ardhurave këtë tremujor regjistroi rreth 39.5 milionë dollarë. Ky suficit vlerësohet me një rritje prej rreth 38 për qind kundrejt tremujorit paraardhës dhe rreth 19 për qind kundrejt tremujorit të dytë të vitit të kaluar.

Mbrapa kësaj rritjeje qëndrojnë të ardhurat nga puna e punëtorëve sezonalë dhe të ardhurat nga investimet e mjeteve valutore të sistemit bankar. Kështu, të ardhurat nga puna këtë tremujor janë rritur 27.8 për qind kundrejt tremujorit të tretë të vitit 2000. Të ardhurat nga investimet e mjeteve valutore të sistemit bankar, këtë tremujor janë rritur me 47.4 për qind kundrejt tremujorit paraardhës, ndërkohë që kundrejt tremujorit korrespondues një vit më parë, këto të ardhura janë rritur me rreth 68 për qind.

2.4 TRANSFERTAT

Suficiti i transfertave korente prej rreth 119 milionë dollarësh ka mbuluar rreth 46.7 për qind të deficitit tregtar të mallrave ose rreth 6 pikë përqindje më shumë se tremujorin paraardhës.

Bilanci i transfertave korente vlerësohet rreth 20.5 për qind më i lartë se ai i periudhës paraardhëse por paraqitet me një rënie prej rreth 2 herë kundrejt tremujorit korrespondues të vitit të kaluar. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rënies së transfertave private dhe shtetërore.




Grafik 6. STRUKTURA E TRANSFERTAVE .

Dërgesat nga emigrantët, për këtë tremujor, vlerësohen rreth 130.4 milionë dollarë dhe paraqiten në rënie ndaj periudhës korresponduese një vit më parë, me rreth 19.5 për qind.

Gjithashtu, transfertat shtetërore kanë rënë me rreth 6 herë kundrejt tremujorit të tretë të vitit 2000. Ndryshe nga viti i kaluar, kur transfertat shtetërore dominoheshin nga ndihmat në mallra, këtë tremujor, transfertat shtetërore dominohen kryesisht nga asistenca teknike.

3. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Bilanci pozitiv i llogarisë kapitale dhe financiare, në fund të periudhës, vlerësohet rreth 67 milionë dollarë dhe ka financuar rreth 79 për qind deficitin e llogarisë korente. Rritja e transfertave korente është shoqëruar, gjithashtu, nga rritja e transfertave kapitale. Kështu, tremujori i tretë regjistroi 61 milionë dollarë, shifër kjo e cila ka kontribuar kryesisht në mbulimin e deficitit korent.



Grafik 7. FLUKSET FINANCIARE (në mln usd).

3.2 DETYRIMET FINANCIARE


Detyrimet financiare të ekonomisë shqiptare, gjatë tremujorit, u rritën rreth 62 milionë dollarë. Kjo rritje përfaqëson rreth 71 për qind të rritjes së tremujorit korrespondues një vit më parë, por vlerësohet rreth 9.8 për qind më e lartë se ajo e tremujorit të dytë të këtij viti. Rritja e detyrimeve financiare përfaqësohet kryesisht në formën e investimeve të huaja direkte¹, huamarrjes së linjave të kredive të huaja dhe depozitave të sistemit bankar.

Investimet e huaja direkte, këtë tremujor, vlerësohen rreth 34 milionë dollarë. Kjo shifër është rreth 21 për qind më e ulët se ajo e tremujorit të dytë dhe rreth 1.9 herë më e ulët se periudha korresponduese e vitit të kaluar. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rënies së ritmit të procesit të privatizimeve në Shqipëri të ndërmarjeve të mëdha shtetërore.

¹ shih shpjeguesin metodologjik.

Borxhi i jashtëm. Kapitaleve të investuara në formën e investimeve direkte i janë shtuar dhe disbursimet e kredive të huaja. Këto disbursime, këtë tremujor, regjistruan rreth 26 milionë dollarë dhe vlerësohen rreth 4 për qind më të ulëta se tremujori paraardhës, ndërkohë që kanë kapur shifrën e të njëjtës periudhë të vitit 2001.

Disbursimet kanë shkuar me rreth 90 për qind në favor të sektorit “Qeveria e Përgjithshme” dhe përfaqësojnë rritjen e detyrimeve të këtij sektori, rreth 7 për qind në favor të sektorit Autoritet Monetare. Financuesi kryesor i qeverisë, ashtu sikurse edhe më parë, mbetet Banka Botërore. Në këto disbursime mund të përmendim përdorimin e kredive në fond me rreth 6 milionë dollarë.



Grafik 8. DETYRIMET NDAJ KREDITORËVE TË HUAJ.

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë tremujorit të dytë të vitit në vazhdim, regjistruan rreth 7 milionë dollarë, dhe u vlerësuan 3 herë më të larta se tremujori i tretë i vitit 2000.


Detyrimet financiare në formën e **depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar** janë rritur me 8.1 milionë dollarë amerikanë. Depozitat janë kryesisht në USD, të cilat zënë rreth 69 për qind të totalit dhe pasohen nga ato në DEM, SFR GRD dhe LIT me rreth 28 për qind.

3.2 MJETET FINANCIARE

Pretendimet në fund të tremujorit të tretë janë rritur me 56 milionë dollarë amerikanë. Kjo rritje përfaqësohet kryesisht nga rritja e zotërimeve në mjete valutore të publikut dhe në formën e depozitave në sistemin bankar, respektivisht me 15 dhe rreth 24 milionë dollarë. Në rritjen e mjeteve financiare kanë ndikuar edhe investimet e portofolit, të cilat në fund të tremujorit vlerësohen rreth 2 herë më të larta se në tremujorin paraardhës ashtu edhe ndaj tremujorit të tretë të vitit 2002.

4. REZERVAT

Flukset hyrëse në mjete valutore në formën e kapitaleve financiare dhe të transfertave korente në *cash*, u reflektuan në rritjen e rezervave valutore të



Grafik 9. REZERVAT E AUTORITETIT MONETAR.

autoritetit monetar me 29.2 milionë dollarë (rreth 1.9 herë më e lartë se ajo e tremujorit të dytë të vitit).

Kjo rritje është regjistruar kryesisht në mjetet valutore me rreth 25 milionë dollarë. Niveli i rezervave valutore në fund të tremujorit të tretë ishte i mjaftueshëm për të përballuar 4.5 muaj importe (import mallrash dhe shërbimesh).